



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.968/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit “Marash - Shped” SH.P.K., me NUI: 810238768, me seli në Rr. Fazli Gashi, në Gjakovë, kundër debitorit Qeveria e Kosovës - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), me seli në rr. “Nëna Terezë” nr. 35, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.574/21 të datës 20.09.2021 të Përbaruesit Privat Gjokë Radi nga Gjakova, jashtë seancës, me datë 30.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Kosovës - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.574/21 të datës 20.09.2021, të Përbaruesit Privat Gjokë Radi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përbarimor P.nr.574/21 i datës 20.09.2021 i lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Marash - Shped” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.574/21 të datës 20.09.2021, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 03/2021 të datës 16.08.2021; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, të ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 15,976.00 €, me kamatëvonesë prej 8 % në vit, duke llogaritur nga dita e lëshimit të faturës, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore dhe nëse debitori nuk e përmbush pagesën e plotë brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij urdhri për përbarim, atëherë përbarimi të zbatohet me bllokimin e llogarive rrjedhëse të debitorit, me regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e pasurisë

së luajtshme dhe të paluajtshme që gjenden në posedim dhe pronësi të debitorëve, deri në pagesën e plotë të borxhit, kamatës dhe shpenzimeve të përbarimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar ndër të tjera se fatura të cilën e ka prezantuar kreditori nuk është dokument përbarimor, ngase nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga debitori, e cila është element esencial i një fature. Më tej ka shtuar se kompania nuk i ka realizuar punimet sipas kontratës dhe planit dinamik, përkundrazi ajo ka përgjegjësi për punët e pa realizuara. I ka propozuar Gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke theksuar kreditori ka filluar procedurën përbarimore tek organi përbarues respektivisht përbaruesi privat duke u bazuar në dokumentin e besueshëm respektivisht faturës dhe i njëjti është i përshtatshëm për përbarim, ngase në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar dhe se në faturë nuk kërkohet edhe nënshkrimi siç pretendon debitori. Më tej ka shtuar se pretendimet e debitorit se kreditori nuk i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës, përkatësisht është vonuar në përmbushjen e tyre të njëjtat nuk qëndrojnë dhe se këto pretendime nuk janë relevante në këtë procedurë përbarimore. I ka propozuar gjykatës që brenda afatit ligjor ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par.

3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – Faturën nr. 03/2021 të datës 16.08.2021, e cila faturë i përmbard të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara punimet të cilat kanë qenë objekt kontratës me numër të prokurimit 207-19-568-5-2-1, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën e pranimit të debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se: Fatura nr. 03/2021 në vlerë prej 15,976.00 € është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 16.08.2021 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e pranimit e datës 16.08.2021 dhe numri i protokollit nr. 1961/2021.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e debitorit në lidhje me mos përmbushjen e kontratës dhe shkeljen e kushteve të kontratës, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbardimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbardimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbardimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 968/22, datë 30.05.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi
palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,
nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,
në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.